



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.1394/6 prot.

Tiranë, më 22.09.2023

VENDIM

Nr. 41, datë 22.09.2023

PËR KONTROLLUESIN “MARJANA BALLIU” PERSON FIZIK

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ, si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Marjana Balliu” Person Fizik (në vijim, “Kontrolluesi ose Alfa Recruitment Ltd”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 130, datë 24.08.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L82204037L, i cili ushtron aktivitetin e shërbimeve si agjenci punësimi, në fushën e marketingut, marketing online, web, marrëdhënie me publikun, konsulencë biznesi.

Alfa Recruitment Ltd kryen ndërmjetësim të klientëve dhe kompanive që nuk operojnë në Shqipëri.

2. Pranë Zyrës së Komisionerit është paraqitur ankesa e subjektit B.V, nëpërmjet të cilës pretendon se, Kontrolluesi kryen aplikime në sistemin online të “Termin”, pranë Ambasadës Gjermane, pa siguruar më parë pëlqimin e subjektit të të dhënave.

Nga verifikimet e kryera në vend, nga grupi i kontrollit rezulton se, Kontrolluesi ka pasur një komunikim të vazhdueshëm me ankuesin nga ku konstatohet se, fillimisht, Kontrolluesi ka aplikuar disa herë pranë ambasadës me kërkesë të vetë ankuesit. Megjithatë, nga komunikimet elektronike (*Whatsapp*) dhe shpjegimet e Kontrolluesit, rezulton se ky i fundit ka ndërprerë aplikimet për ndërmjetësim të punësimit, pas kërkesës së ankuesit, për të mos kryer më aplikime në emër të tij.

Zyra e Komisionerit konstaton se, sistemi online i “Terminit” është publik dhe i hapur, i cili ofrohet nga ambasada gjermane për aplikantët, si dhe për çdo palë të interesuar.

Gjithashtu, nga verifikimi i provave të administruara gjatë hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit vlerëson se llogaria dhe adresa e email-it që është përdorur në emër të subjektit të të dhënave, nuk përputhen me të dhënat e punonjësve apo të email-eve të administruara nga Kontrolluesi.

3. Konstatohet se, në zbatim të VKM nr. 101, datë 23.02.2018 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencive Private të Punësimit”, Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale, me qëllim:
 - a) Informimin, këshillimin, si dhe vlerësimin e kërkesave të aplikimeve për ndërmjetësim, për qëllime punësimi;
 - b) Kërkimin e vendeve të punës;
 - c) Ndërmjetësimin për përcaktimin e kushteve dhe të lidhjeve të marrëdhënive të punës, ndërmjet punëkërkuarit dhe punëdhënësit.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë, “punonjës”, “klientë”, “vizitorë të faqes së internetit” (www.alfa-recruitment.com), si dhe “vizitorë të ambienteve të zyrave”. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

Stafi i agjencisë kryen aplikime për klientët për “Termin” për vizë në ambasadat, me të cilat kryen ndërmjetësimin. Gjithashtu, stafi i Kontrolluesit, përgatit dosje dhe dokumentacionin e nevojshëm, si dhe kryen depozitimin e tyre pranë institucioneve përkatëse si ambasada, konsullatë, zyrë emigracioni etj. Të dhënat e klientit që mblidhen nga Kontrolluesi, konsistojnë në: “emër, mbiemër, numër kontakti, adresa,

datëlindja, vendlindja, arsimi, shkolla, dëshmi të njohjes së gjuhëve të huaja, leje drejtimi/patenta, pasaporta, eksperiencia në punë, info shtesë të tjera”.

Konstatohet se, të dhënat e “*ish-punëmarrësve*” dhe “*klientëve*”, ruhen në arkivën fizike dhe elektronike (*email*) të Kontrolluesit. Përmbajtja e dosjeve personale të ish-punëmarrësve, përmban dokumente të fotokopjuara të tilla, si: “*jetëshkrim, kopje të kartës së identitetit, adresa e banimit*”. Gjithashtu, të dhënat e klientëve, si “*emër, mbiemër, nr. tel, adresa, arsimimi*”, mbahen nga Kontrolluesi, pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi ka detyrim të përpunojë të dhënat personale, për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë grumbulluar dhe përpunuar, si dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar, të realizojë shkatërrimin e tyre, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me qëllimin e përpunimit dhe parashikimet ligjore specifike.

4. Kontrolluesi ka të instaluar një sistem video survejimi, me anë të të cilit kryen monitorimin e ambienteve fizike gjatë ushtrimit të aktivitetit. Njësia qendrore e mbikëqyrjes së sistemit CCTV është vendosur në ambientet e Kontrolluesit. Sistemi i survejimit CCTV, është i përbërë nga katër kamera, me anë të të cilave kryen mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme (zyrave dhe korridorit), në kundërshtim me parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011, të Komisionerit “*Mbi Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 11*”).

Gjithashtu, Kontrolluesi nuk informon subjektet mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, nëpërmjet sistemit të video survejimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 3*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i survejimit audio/video (CCTV). Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si: “*video*”, “*imazhe*” dhe “*zëri/audio*”, janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, mbikëqyrja e ambienteve të zyrave të punonjësve nëpërmjet sistemit të video/audio survejimit, është në kundërshtim me parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit, si dhe Udhëzimin nr. 11 të Komisionerit.

Gjithashtu, në zbatim të nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video survejimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit.

Kontrolluesi ka publikuar në faqen zyrtare www.alfa-recruitment.com “Politikat e Privatësisë”, të cilat janë modele standarde ndërkombëtare të politikave të privatësisë. Konstatohet se, Alfa Recruitment Ltd nuk informon në gjuhën shqipe subjektet e të dhënave (klientë, vizitorë), për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për fshirje dhe/ose korrigjim të të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Gjithashtu, Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhënat e subjekteve të të dhënave, nëpërmjet dokumentit “tip” Formular Aplikimi. Konstatohet se në formularin “tip”, nuk është parashikuar një rubrikë e veçantë, në të cilën të informohen subjektet të të dhënave, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale, të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja, sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Kur mbledh të dhëna personale, Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij, etj.

5. Kontrolluesi ka lidhur marrëveshje kontraktuale me palët e treta, për marrjen e shërbimeve, konkretisht, “Alfa Recruitment Ltd” ka lidhur kontratë me “SH.P.S.F Royal Security”, datë 11.07.2023, me objekt “Sigurimi me anë të sistemit të alarmit, kamera të vendosura në objektin zyrë (CCTV)”.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së marrëveshjes së sipërcituar, rezulton se në përmbajtje të saj, nuk janë reflektuar detyrimet e parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës, të garantojë përcaktimin e rregullave për marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave tek përpunuesi, të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 19, çdo kontratë përpunimi (outsourcing), që ka për qëllim përpunimin e të dhënave personale, duhet të përmbajë dispozita konkrete që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit shqiptar. Çdo kontratë e tillë, duhet të parashikojë çdo masë që merr përpunuesi për të siguruar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave.

6. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, si dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit rezulton se, Kontrolluesi ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, pas marrjes dijeni të urdhrin të hetimit administrativ. Megjithatë, konstatohet se “Njoftimi” ka mangësi në deklaram, sa i përket rubrikave të formularit, si vijon:

- i. Deklarimin në rubrikën 3, të formularit të njoftimit *“kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen”*, të tilla si *“vizitorë”*;
- ii. Deklarimin në rubrikën 4, të formularit të njoftimit *“kategoritë e të dhënave personale që përpunohen”*, të tilla si *“Numri personal i identifikimit, Jeta profesionale, Formimi-Diplomat, Imazhe nëpërmjet kamerave të vëzhgim-regjistrimit (CCTV)”*;
- iii. Deklarimin në rubrikën 6, të formularit të njoftimit *“qëllimi i përpunimit”*, të tilla si *“Mbikëqyrje e ambienteve nëpërmjet kamerave të vëzhgim-regjistrimit (CCTV)”*;
- iv. Deklarimin në rubrikën 7, të formularit të njoftimit *“Marrësi i të dhënave personale”* të tilla si, institucionet shtetërore ku bëhen deklaram;
- v. Deklarimin në rubrikën 8, të formularit të njoftimit *“Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale”*, të tilla si vendet me të cilat kryhet ndërmjetësimi;
- vi. Deklarimin në rubrikën 9, të formularit të njoftimit *“Mjetet e përpunimit të të dhënave”*, të tilla si mjetet mekanike;
- vii. Deklarimin në rubrikën 10, të formularit të njoftimit *“Masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes së të dhënave”*.

Konstatimet e mësipërme, janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për “Njoftim” mbi përpunimin e të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

7. Kontrolluesi nuk disponon *“Rregullore për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të

dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Gjithashtu, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në zbatim të parashikimeve të nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një Rregullore specifike “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, i cili u dorëzua fizikisht pranë ambienteve të Kontrolluesit, gjithashtu edhe nëpërmjet postës elektronike.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesja e Kontrolluesit u paraqit në seancë dëgjimore, gjatë së cilës parashitroi verbalisht qëndrimin e saj, lidhur me konstatimet e grupit të hetimit.

Kontrolluesi, gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, parashitroi pretendimet, si më poshtë:

- Alfa Recruitment Ltd ushtron aktivitetin e shërbimeve si agjenci punësimi, me qëllim ndërmjetësimin në tregun e punës duke respektuar legjislacionin e fushës. Ndërsa, në lidhje me detyrimet që burojnë nga legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale nuk ka pasur informacion të mëparshëm. Megjithatë, nga momenti i njohjes me dispozitat e sanksionuara në Ligj, do të ndërmerren veprimet përkatëse për përmbushjen e detyrimeve ligjore.

Lidhur më këtë pretendim, Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi ushtron veprimtarinë prej një kohe të gjatë dhe po ashtu ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar, është në fuqi që prej vitit 2008, dhe si rrjedhojë prezumohet i ditur nga momenti i botimit të tij në Fletoren Zyrtare. Në këtë kuadër, Kontrolluesi nuk mund të justifikojë mosplotësimin e detyrimeve ligjore për shkak të mosnjohjes së ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a”, “b”, “d” dhe “dh” të pikës 1, të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “*Përpunimi i të dhënave personale*”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, me informimin dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 22, 27, 29, 30, 39 pika 1, gjerat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit;
- 3- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit;

- 4- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit;
- 5- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të Ligjit;
- 6- Kontrolluesi, të ketë në vëmendje proceset e përpunimit të të dhënave personale, për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
- 7- Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, për të gjitha proceset përpunuese, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;
- 8- Kontrolluesi të ndalojë menjëherë përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale përmes sistemit të survejimit CCTV në ambientet e punës së punonjësve, si dhe të shkatërrojë në mënyrë të parikuperueshme të dhënat “*video/audio*” të mbledhura për subjektet e të dhënave “*punonjës*”, të cilat janë përpunuar, në kundërshtim me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të Ligjit. Në këtë kuadër të mbajë evidenca për shkatërrimin;
- 9- Kontrolluesi, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, në zbatim të detyrimeve të nenit 18 të Ligjit;
- 10- Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit duke specifikuar detyrimet midis palëve dhe të monitorojë në vijimësi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjet me përpunuesit, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
- 11- Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “*Njoftimit*”, në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
- 12- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e rregullores “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
- 13- Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti, brenda afateve, si vijon:

- i. menjëherë, detyrimin e përcaktuar në pikën 8 më sipër;
- ii. vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 6 dhe 7 më sipër;
- iii. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 9 dhe 11 më sipër;
- iv. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 10 dhe më sipër;
- v. brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 12 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

14- Kontrolluesi të njoftojë Zyren e Komisionerit për masat e marra;

15- Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;

16- Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 22.09.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi